



UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
“ISA BOLETINI”

Rruga Ukshin Kovaqica, Mitrovicë, Republika e Kosovës
<http://www.umib.net>; Tel: +381-28535725/535727

Kryesuesi i KD
Dr. sc. Ali Topalli

Nr. Prot. 530
Dt 28.03.2019

Në bazë të nenit 2 të Rregullave dhe procedurave për zgjedhjet e përgjithshme në UMIB dhe 11 të Rregullores për zgjedhjet e studentëve të Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini” (UMIB), Këshilli Drejtues (KD) i Universitetit në mbledhjen e mbajtur më 28.3.2019, mori:

V E N D I M

I. Shpallen zgjedhjet e studentëve të Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini”, të cilat do të mbahen më 25.04.2019.

1. Komisioni Qendror Zgjedhor do të konstituohet nga kryesuesi i KD brenda dy ditëve pas ditës së shpalljes të zgjedhjeve.
2. Të gjitha organizatat të cilat do të marrin pjesë në zgjedhjet studentore në vitin 2019 duhet të jenë të regjistruara në Ministrinë e Administratës Publike dhe të konfirmuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.
3. Në zgjedhjet studentore mund të marrin pjesë organizatat studentore, të cilat janë regjistruar 15 ditë para datës së zgjedhjeve, respektivisht deri më 10.04.2019.
4. Zgjedhjet studentore do të zhvillohen në pajtim me Rregulloren për zgjedhjet e studentëve dhe sipas planit dinamik të hartuar nga Komisioni i zgjedhjeve.

II. Shpallen zgjedhjet e përgjithshme të Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini”, të cilat do të mbahen më 16.5.2019.

1. Zgjedhjet e përgjithshme mbahen me qëllim të zgjedhjes së këshillave të fakulteteve dhe të organeve të tjera në fakultete dhe universitet.
2. Komisioni Qendror Zgjedhor do të themelohet nga KD në pajtim me nenin 16, pika 2 të Rregullave dhe procedurave për zgjedhjet e përgjithshme në UMIB.
3. Zgjedhjet e përgjithshme do të zhvillohen në pajtim me Rregulloret dhe Statutin e UMIB-it.
4. Zgjedhjet e përgjithshme do të mbahen sipas planit dinamik të hartuar nga KQZ dhe të miratuar nga KD.

III. Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe duhet të shpallet në web faqen e Universitetit të Mitrovicës.



Dr. sc. Ali Topalli

Kryesues i KD